



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Departamenti i **Biologjisë** në *Fakultetin e Shkencave të Natyrës* në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, për nevojat e tij për vitin akademik 2022-2023, shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme.

Kriteret e përgjithshme e të veçanta për pozicionin e punës **personel akademik me kohë të pjesshme** për konkurrim janë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba dhe Master i Shkencave apo ekuivalente me të) brenda ose jashtë vendit në fushën e *Botanikës/Zoologjisë/Biostatikës/Mikrobiologjisë/Biologjisë së Aplikuar*, në profilin Biologji Bimore, Biologji Shtazore, Biologji e Aplikuar, me notë mesatare mbi 8.0. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Të kenë përvojë në mësimdhënie në IAL.
3. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi.
4. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **14.09.2022** deri **23.09.2022** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
4. Dokumentacionin shoqëruar përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE

Përveç konkurrimin me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen **intervistës** në departament.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në rrugë postare **14.09.2022** deri **23.09.2022**.

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim në Fakultetin i Shkencave të Natyrës
Departamenti i Biologjisë
Elbasan**